



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



Në mbështetje të Nenit 48 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 05/L -042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, i shpallur në Gazetën Zyrtare Nr. 4/2016 datë 14.01.2016, bazuar në rekomandimin nr. 532/7 datë 19.09.2017 të komisionit i themeluar me Vendim nr. 405 dt 15.08.2016 dhe Vendimi me nr 405/2 20.09.2016 dhe pas shqyrtimit të kërkesës me nr. 1758 datë 15.09.2017 të z. Nazif Asllani, Kryeshef Ekzekutiv i KRU "Bifurkacioni", për aprovimin e 5 (pesë) Rregulloreve të brendshme të kësaj kompanie, Drejtori i Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit merr këtë:

VENDIM

1. Miratohen Rregulloret e KRU "Bifurkacioni" SH.A Ferizaj, si në vijim:
 - 1.1. Rregullorja Nr. 01/2017 për Zgjidhjen e Ankesave të Konsumatorëve, pjesë të kësaj rregullore janë anekset;
 - 1.1.1. Aneksi nr. 1 - Forma e ankesës/ kërkesës së konsumatorit
 - 1.1.2. Aneksi nr. 2 - Forma e vendimit për zgjidhjen e ankesave të konsumatorëve
 - 1.2. Rregullorja Nr. 02/2017 për Procedurat e Lidhjes së Konsumatorëve në Shërbimet e Ujit, pjesë të kësaj rregullore janë anekset;
 - 1.2.1. Aneksi nr. 1 - Formulari i aplikacionit për lidhje,
 - 1.2.2. Aneksi nr. 2 - Formulari i aplikacionit për legalizimin e lidhjes të paautorizuar,
 - 1.2.3. Aneksi nr. 3 - Formulari i kushteve teknike për ekzekutimin e lidhjes,
 - 1.2.4. Aneksi nr. 4 - Forma e vendimit për aprovimin e lidhjes,
 - 1.2.5. Aneksi nr. 5 - Forma e vendimit për refuzimin e lidhjes,
 - 1.2.6. Aneksi nr. 6 - Forma e regjistrimit të konsumatorit të ri.
 - 1.3. Rregullorja Nr. 03/2017 për Procedurat e Ndërprerjes së Shërbimeve të Ujit, pjesë të kësaj rregullore janë anekset;
 - 1.3.1. Aneksi nr. 1 - Formati i vërejtjes për ndërprerje të shërbimit,
 - 1.3.2. Aneksi nr. 2 - Formati i vendimit për ndërprerje,
 - 1.3.3. Aneksi nr. 3 - Procesverbali i inspektimit të shërbimeve të ujësjellësit,
 - 1.4. Rregullorja Nr. 04/2017 për Procedurat e Faturimit për Shërbimet të Ujit.

- 1.5. Rregullorja Nr. 05/2017 për Matjen e Konsumit të Ujit, pjesë të kësaj rregullore janë anekset;
 - 1.5.1. Aneksi nr. 1 - Formati i raportit të inspektimit të ujëmatësi,
 - 1.5.2. Aneksi nr. 2 - Formati i urdhërësës së punës,
 - 1.5.3. Aneksi nr. 3 - Forma e kërkesës për verifikimin e saktësisë së ujëmatësit,
 - 1.5.4. Tabela udhëzuese për diametrin e ujëmatësit.
2. Për zbatimin e Rregulloreve sipas pikës 1 të këtij vendimi, obligohet të përkujdeset kryeshefi ekzekutiv i KRU "Bifurkacioni" SH.A Ferizaj,
3. Rregulloret e cekura në pikën 1 të këtij vendimi, fillojnë së zbatuari 15 ditë pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen zyrtare të KRU "Bifurkacioni".
4. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e nënshkrimit.

T'i dërgohet;
Ix Arkivit të ARRU
Ix Kryeshefit Ekzekutiv KRU "Bifurkacioni"

Drejtori i ARRU


Raii PRETENI